**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E GJAKOVËS**
**OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

# Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 20.02.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2 ) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.02.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Hasan Alija B.I.** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme"- Lot 23: "Transporti i nxënësve në relacionin Molliq-Batushë dhe anasjelltas" , Nr. i prokurimit- 632-23-327-2-1-1, nxjerr:**

## VENDIM

**1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: **Hasan Alija B.I., e dt.15.02.2023**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme"- Lot 23: "Transporti i nxënësve në relacionin Molliq-Batushë dhe anasjelltas" , Nr. i prokurimit- 632-23-327-2-1-1,** kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 31.01.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.

2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË , i publikuar me datë: 31.01.2023;**

3.Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj përmirësimin e Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.

4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

**A r s y e t i m**

Operatori Ekonomik **Hasan Alija B.I., me dt.15.02.2023**, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit **"Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme"- Lot 23: "Transporti i nxënësve në relacionin Molliq-Batushë dhe anasjelltas" , Nr. i prokurimit- 632-23-327-2-1-1.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 20.02.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar dhe Autoriteti kontraktues mbetet pranë sqarimeve shtesë të cilat janë publikuar në platformë elektronike me dt.09.02.2023((të cilat do t'i bashkangjiten këtij vendimi), prandaj Autoriteti kontraktues do të vazhdoj me procedurat e prokurimit

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

**Këshilla juridike:**
Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqeseankesë pranë OSHP-së . **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

**Faton Gutaj**

**Menaxher i Zyrës së Prokurimit**

**Kopje:** Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit te Komunës;
Te gjitha palëve te interesuara;

REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

# KOMUNA E GJAKOVËS

OPŠTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Aktiviteti i prokurimit: MIRËMBAJTJEN E OBJEKTEVE KOMUNALE TË KOMUNËS SË GJAKOVËS

| Nr. I Prokurimit[1] | 632 | 23 | 327 | 211 |
|---|---|---|---|---|

**Datë:09.02.2023.**

**SQARIME shtese për OE**

Te nderuar,

Ne përputhje me nenin 53 te LPP, Komuna e Gjakovës ka pranuar **pyetje nga Operatoret Ekonomik** ne lidhje me kërkesat e përcaktuara ne Dosjen e tenderit : **Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme**

Në përputhje me nenin 53 te LPP, AK përgjigjët ne pyetjet e parashtruara nga OE si me poshtë:

| Nr. | Përshkrimi | Pyetja e parashtruar | Sqarim/ Informate shtese nga AK |
|---|---|---|---|
| 1. | **Përshkrimi i çmimeve** | | Lidhur me pytjrn e një Operatori Ekonomik ju sqarojmë:Transportin e nxënëseve në shkollën "Jahë Salihu" në Molliq, përkatësisht **Loto nr 23** Transporti i nx. në relacionin Molliq,Batushë dhe anasjelltas<br>I cili ka këtë parallogaritje: Verifikim i kilometrave dhe sa ndërrime ka shkolla në ditë. Pra në kontratën e vitit të kaluar ka qenë çmimi për çdo nxënës dhe kjo linjë ishte si në vijim: Relacioni Molliq, Batushë dhe anasjelltas distanca 3.5 km një drejtim, kurse çmimi |

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | Sipas Ligjit Nr. 04/L-042, për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, dhe Nenit 53 kërkojm sqarim dhe informacione shtes se si është parashikura vlera për "Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme" - Lot 23 "Transporti i nxënësve në relacionin Molliq, Batushë dhe anasjelltas",ku vlera e parashikurar është 9,750.00€ ndërsa te Seksioni II.Fleta e të Dhënave të Tenderit (FDT), Neni 5.4 citoj "Kjo kontratë publike kornizë ka kohëzgjatje prej 24 muajsh dhe është efektive prej datës në të cilën ajo hyn në fuqi".<br><br>Si është e mundur që kjo kontratë të jetë 24 muaj (2 vjet) e me çmim 9,750.00€.<br><br>Një sqarim: Kontrata e vitit të kaluar është nënshkruar me vlerë prej 13,311.00€. dhe ka qenë e paraparë 180 ditë, afati i përfundimit ishte 12 muaj (1 vite), ndërsa këtë që ju keni parashikuar për vitin 2023, me çmim 9,750.00€. për 250 ditë, afati i përfundimit 24 muaj (2 vite) ne këtë menyrë ky projekt nuk mund të realizohet sepse duhet llogaritur edhe ngritjen e çmimeve (inflacioni i lartë), po ashtu ne Paramasë është llogaritur vetëm vajtje - ardhje por me kerkesë të drejtorit të shkollës kishte tri vajtje dhe ardhje, prandaj konsiderojmë se edhe këtë vite mbetet e njëjtë pra tri vajtje- ardhje,<br><br>Në vazhdim gjeni llogaritjen se deri ne cilen vlere është i mundur të realizohet ky projekt.<br><br>Punëtori - Shoferi = 25€ -30 €/ditën<br>Nafta = 30- 35 litra diten x 1.50€ = 45.00€ - 52.50€/ditën<br>Regjistrimi i automjetit = 1,000.00€/vjetore<br>Mirëmbatja e automjetit (goma, bateria, ulje, te tjera) = 2,250.00€/ vjetore<br>Kalkulimet:<br>Punëtori = 250 ditë x 25.00€/diten = 6,250.00€ ⇨ 250 ditë x 30.00€/diten = 7,500.00€<br>Nafta = 250 ditë x 45.00€/L = 11,250.00€ ⇨ 250 ditë x 52.50€/L = 13,125.00 €<br>Regjistrimi = 1,000.00€<br>Mirëmbatja e automjetit (goma, bateria, ulje, te tjera) = 2,250.00€<br>Totali: 20,750.00€ ⇨ 23,875.00€<br>Prandaj kërkojmë nga ju si Autoritet Kontraktues që të rishqyrtoni mundesin e ndryshimit dhe korigjimit të paramases sepse nëse mbetet e tillë ajo do të na demtojë të gjithë si nxënësit duke ju pa mundësuar shkuarjen në shkollë dhe OE të cilet do të ofertojnë sepse do t'ju shkaktojë humbje të madhe. | ishte 85nxënës x 0.90 euro për nxënës që i ka rënë 76.5 euro ditore. Duke shikuar që vërtettë çmimi për çdo nxënës nuk korrespondonte korrekt me linjat tjera këtë vit kemi bërë ofertë korrekte të barabartë për secilin operator ekonomik. Pra paraprakisht kemi verifikuar linjat një nga një për secilën shkollë, kurë jemi në kë linjë po ju shpjegoj në verifikimin tonë na del që kontrata e kaluar ka patur 3.5 km një drejtim, tani ka 4.2 km një drejtim dhe stacionet janë kështu në **Loton 23 të tenderit të publikuar për çmim për km jo për nx. Pra stacionet:Molliq, L.Uriel,L.Zajmi,Batushë qendër,LTolaj** dhe anasjelltas dhe na rezulton që ne nuk kemi si në kontratën e kaluar 3.5 km një drejtim, por më shumë 4.2 dhe ne tender aktual kemi llogaritur vajtje ardhje 8.4 km dhe çmimi për automjet Autobus 4.6 euro për 1 km që I bije 39 euro dita në vetem 8.4 km distanë nga shkolla në destinacion. Çmimet e llogaritura afërsisht në tenderin aktual të publikuar janë:<br><br>Autobus Distanca nga 0-20 km, çmimi për 1 km= 4.60 euro<br>Minibus Distanca nga 0-10 km = 4.30 euro<br>Distanca nga 10-20 km = 2.90 euro<br>Distanca nga 20-30 km = 1.50 euro<br>Distanca nga 30-40 km = 1.10 euro<br>Distanca nga 50-60 km = 1.00 euro |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | | |

**Me respekt:**
**Shëno emrin dhe nënshkrimin**
**Faton Gutaj**

______________________